

KËRKESË
Nr. 726/4, datë 21.8.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i shëtitores së qytetit Bajram Curri”, Bashkia Tropojë.

Subjekti kërkuar është Bashkia Tropojë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 313 768 (treqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I BRENDSHËM
Romina Kuko

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: “Rehabilitim i shëtitores së qytetit Bajram Curri”
Bashkia Tropojë

Nr	Emri Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	ZK	Nr. pasurisë	Sip. e truallit/ m ²	Çmimi i truallit/ lekë/m ²	Vlera e truallit/lekë	Pemëto				Vlera totale	Shënime
							Rrënjë (rrush)	Vlera/lekë	Rrënjë (kumbull, mollë)	Vlera/lekë		
1	Guxim Gjyriqi Agron Gjyriqi Mimoza Metaliaj Valdete Kermaja Xhevahire Gjyriqi	1347	5/26	35	1873	65555	15	7500	5	7500	80555	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Guxim Gjyriqi Agron Gjyriqi Mimoza Metaliaj Valdete Kermaja Xhevahire Gjyriqi	1347	1/212	39	1873	73047	10	5000	5	7500	85547	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Arben Gjyriqi Bedri Gjyriqi Lumturie Gjyriqi Zyrafete Buçpapaj	1347	5/34	35	1873	65555	10	5000	0	0	70555	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Arben Gjyriqi Bedri Gjyriqi Lumturie Gjyriqi Zyrafete Buçpapaj	1347	5/48	38.5	1873	72111	10	5000	0	0	77111	Konfirmuar nga ZVRPP
Shuma						276268	45	22500	10	15000	313 768	